




## Provimi teorik (shofer i makinave pirun)

1. Çfarë është rregullorja e parandalimit të aksidenteve?
  - a) Një rekomandim sigurie
  - b) Një dispozitë ligjore
  - c) Një manual përdorimi
2. Kush duhet ta respektojë rregulloren e parandalimit të aksidenteve?
  - a) Vetëm sipërmarrësi
  - b) Çdo qytetar
  - c) Sipërmarrësi dhe gjithë të tjerët në kompani
3. A duhet të përballët një shofer me pasoja të rënda ligjore nëse gjatë ngarkes së një kamioni industrial ka shkaktuar aksident me pasoja në njerëz si pasojë e pakujdesisë?
  - a) Po
  - b) Jo
4. Si ndikon distanca nga qendra e ngarkesës në kapacitetin ngritës të makinave pirun?
  - a) Sa më i madh të jetë LSP, aq më e vogël duhet të jetë ngarkesa
  - b) Sa më i madh të jetë LSP, aq më e madhe duhet të jetë ngarkesa
  - c) Sa më i vogël të jetë LSP, aq më e madhe duhet të jetë ngarkesa
5. Kujt i lejohet të drejtojë një kamion industrial me ndenjëse për shoferin?
  - a) Kushdo që ka një patentë për ngarje automjetesh
  - b) Çdo punonjës
  - c) Vetëm persona të përshtatshëm mbi 18 vjeç që kanë certifikatë kualifikimi të suksesshëm dhe porosi të posaçme me shkrim
6. Kush mban përgjegjësi i pari (përgjegjësi kryesore) për stilin e drejtimit të një kamioni industrial?
  - a) Eprori
  - b) Shoferi
  - c) Riparuesi
7. A duhet të veshë një shofer kamioni industrial veshje të përshtatshme dhe pajisjet e detyrueshme mbrojtëse personale?
  - a) Po
  - b) Jo
8. Sa shpesh duhet të kryejë shoferi i një kamioni industrial një kontroll funksional të mjetit?
  - a) Çdo ditë sapo fillon punën
  - b) Rreth dy herë në javë
  - c) Vetëm kur dyshon se në mjet ka diçka që nuk shkon
9. Kush duhet ta kryejë inspektimin kryesor të një kamioni industrial të paktën një herë në vit në bazë të rregullores së parandalimit të aksidenteve?
  - a) Një shofer që ka përvojë të mjaftueshme drejtimi
  - b) Një mekanik automjetesh me përvojë disavejeçare
  - c) Një specialist i kualifikuar për kamionë industrialë, p.sh. nga prodhuesi ose kompani të specializuara
10. Çfarë duhet të bëjë një shofer kamionësh industrialë, nëse vëren se një kamion industrial ka defekt?
  - a) Vazhdon punën duke treguar kujdes
  - b) Vazhdon punën deri në përfundim të turnit dhe më pas njofton eprorin e tij për problemin
  - c) Ndërpret punën, njofton përkatësisht eprorin për problemin dhe pret udhëzimet e këtij të fundit
11. Ku mund të lëvizë shoferi me kamionët industrialë?
  - a) Në gjithë hapësirat e kompanisë
  - b) Në të gjitha rrugët që shoferi i konsideron të përshtatshme
  - c) Vetëm në rrugët e autorizuar nga eprori apo përfaqësuesit e tij
12. A lejohet të kryhen punë që janë në kundërshtim me rregullat?
  - a) Po, nëse kërkojnë vetëm pak kohë
  - b) Po, sepse përndryshe puna do të kushtonte shumë
  - c) Jo, në asnjë rast! Kujdes, sipërmarrësi dhe shoferi mbajnë përgjegjësi
13. A mund të vendosen ngarkesat në rrugët e transportit?
  - a) Po
  - b) Po, por vetëm për pak kohë
  - c) Jo, sepse rruga e transportit publik duhet të qëndrojë gjithmonë e lirë, me një distancë sigurie prej të paktën 0,50 m nga të dyja anët e mjetit në raport me elementët e fiksuar të ambientit
14. Si dhe me çfarë distancë të mundshme duhet të parakalonin njerëzit?
  - a) Me shpejtësi mesatare dhe me një distancë prej të paktën 0,50 m
  - b) Në korsi
  - c) Duke i rënë borisë dhe pa ndonjë distancë të veçantë
15. Çfarë nuk duhet të bëni në asnjë mënyrë kur furnizoheni me karburant dhe kur manovroni me baterinë e mjetit?
  - a) Të bisedoni me kolegët
  - b) Të pini duhan dhe të mbani një burim flake
  - c) Të uleni
16. Përse duhen mbajtur pajisjet mbrojtëse personale (mbrojtëse për fytyrën, dorashka dhe përparëse mbrojtëse) kur manovroni me baterinë e mjetit (karikim, mbushje me lëngun e baterisë)?
  - a) Sepse lëngu i baterisë është gërryes dhe si pasojë e një gabimi, mund të ndodhë një shpërthim i shpejtë i baterisë
  - b) Sepse lëngu i baterisë ka erë të keqe
  - c) Sepse bateria duhet të ketë jetëgjatësi
17. Kur ndërrohen cilindrat e gazit në kamionët industrialë duhet të ruhet veçanërisht një distancë prej të paktën 3 m nga vendshkarkimet në dyshe, hyrjet e bodrumeve ose të ngjashme, të mbyllet valvula e cilindrit të boshatisur, dhe të fiksohen me kujdes tubat e lidhjes së gazit. Në ç'rast është e mundur të devijoni nga kjo procedurë?
  - a) Nëse jam me nxitim
  - b) Nëse po afron ora e mbylljes së punës
  - c) Asnjëherë
18. A duhet të pastrohet (digjet) tymi i shkarkuar (bloza) në një pirun me naftë?
  - a) Po, përndryshe ajri i ambientit do të ndotej shumë dhe mund të dëmtohet motori
  - b) Jo
19. Në kamionin industrial është fiksuar një pajisje ndihmëse. Çfarë duhet të merrni parasysh në këtë rast, në raport me përdorimin e zakonshëm?
  - a) Asgjë të veçantë
  - b) Të jem më i vëmendshëm
  - c) Manualin përkatës të përdorimit dhe dhe udhëzimet e funksionimit, si p.sh. reduktimin e kapacitetit mbajtës dhe përdorimin e posaçëm
20. Përse nuk lejohet të përdorni çdo ashensor me një kamion industrial?
  - a) Sepse në rrethana të caktuara, kapaciteti mbajtës i ashensorit dhe përmasat e tij nuk janë të mjaftueshme
  - b) Sepse disa ashensorë lëvizin shumë ngadalë
  - c) Sepse jo gjithë dyert e ashensorëve kanë dritare



21. Përse kur hyni apo dilni nga ashensori, nuk duhet të ketë persona të tjerë brenda tij?
- Sepe nuk garantohej mbikëqyrja e personelit
  - Pasi për shkak të vendit të ngushtë rreziku i shtypjes është i lartë
  - Për shkak se tymrat e pirunit janë të dëmshëm
22. A ju lejohej të merrni persona të tjerë në kamionin industrial?
- Po, nëse i njoh këta persona
  - Po, por vetëm nëse mjete është konfiguruar posaçërisht dhe ka një miratim për këtë
  - Jo
23. Për çfarë duhet të tregoni kujdes përpara se të ngarkoni ose shkarkoni mjete, p.sh. kamionë, rimorkio, pjesë të çmontueshme dhe vagonë?
- Nëse shoferi është larguar nga kabina
  - Nëse shoferi i kamioni nuk e tejkalon kohën e lejueshme të ngarjes
  - Nëse mjete është i ndaluar dhe i siguruar kundër lëvizjes nga vendi
24. Çfarë merrni parasysh para së gjithash, kur vendosni një platformë ngarkuese në mjet për ngarkimin dhe shkarkimin?
- Platforma ka kapacitet mbajtës të mjaftueshëm, është mbështetur plotësisht mbi rampë dhe është siguruar kundër rrëshqitjes
  - Nëse hapësira e ngarkimit është e përshtatshme ose jo
25. Sa lart lejohet normalisht të vendosni një stivë p.sh. paletash?
- Aq lart sa e lejon lartësia e hapësirës
  - Në ambient të brendshëm 6 herë më lart, jashtë 5 herë më lart se thellësia më e vogël e përgut
  - Aq lart sa e mundëson kamioni industrial
26. Kur duhet hequr një ngarkesë menjëherë si pasojë e rrezikut të rrëzimit?
- Kur pjerrësia e saj është më shumë se 2% në drejtim vertikal
  - Nëse qëndron diagonalisht dhe nuk mbështetet në pjesë të godinës
  - Nëse përbëhet nga mallra delikate që thyhen
27. Në kompani janë vendosur sinjalistika rrugore si në rrugët publike. A duhet t'i respektoni ato?
- Po, në çdo rast
  - Po, nëse jam duke drejtuar një kamion industrial me ndenjëse shoferi
  - Jo
28. Si e ngjisni një kamion industrial nëpër një hyrjen/daljen e një salle që ka një perde me shirita plastikë?
- Jap sinjal (i bie borisë) dhe vazhdoj të ngas përpara
  - Ul shpejtësinë e lëvizjes me ritmin e hapave dhe ngas me shumë kujdes
  - E ngas shpejt, në mënyrë që perda me shirita të hapet mirë
29. A duhet të kryeni riparime, p.sh. në shasinë e kamionit industrial?
- Po
  - Po, nëse nuk është i pranishëm personel mirëmbajtjeje
  - Po, por vetëm nëse jam trajnuar dhe më është ngarkuar si detyrë
30. Përse në rast procesesh të veçanta, p.sh. kur punoni me një platformë pune, kërkohet leje shtesë nga sipërmarrësi apo perfaqësuesi i tij?
- Sepe kryerja e procesit zgjat shumë
  - Sepe duhet të respektohen kërkesa të veçanta të sigurisë
  - Sepe në platformë punojnë dy persona


31. Kur i lejohej shoferit ta lërë çelësin ndezës në kamionin industrial?
- Kur largohet nga puna në përfundim të orarit
  - Kur i kërkohet të shkojë në zyrën e eprorit
  - Kur zbret shkurtimisht, p.sh. për të kontrolluar ngarkesën dhe kur është pranë kamionit industrial dhe brenda rrezes së shikimit
32. Si e parkon një shofer i përgjegjshëm kamionin industrial, para se të largohet prej tij?
- Aktivizon vetëm frenat e parkimit
  - E parkon pranë hyrjes
  - Parkon në vendet e posaçme. Ngren frenat e parkimit, ul mekanizmin ngritës në pozicionin e poshtëm dhe siguron çelësin ndezës.
33. Cila prej këtyre makinave pirun me ngarkesa të njëjta ka më shumë gjasa të anohet?
- Piruni 1b) Piruni 2



34. Si duhet ta mbajnë makinat pirun ngarkesën në mal? Cili stil drejtimi është i gabuar?



35. Një arkë është  $l = 2\text{m}$ ,  $b = 2\text{m}$ ,  $h = 2\text{m}$ , me distancë nga qendra engarkesës 1 m dhe një peshë prej 1400 kg. A është e lejueshme ta transportoni arkën me pirun nëse diagrama e kapacitetit mbajtës është si më poshtë?



- Po
- Jo